



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 68F Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM
Nr. 265, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik për projektin “Marina dhe Jahtet e Durrësit” – Faza I, me aplikues dhe zhvillues “Durrës Marina sh.a”, realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Luan Përzhita;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Subjekti zhvillues duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë ndjekjen periodike ditore të punimeve në tokë dhe nën ujë dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR
Elva MARGARITI

